

VENDIM
Nr. 8, datë 10.6.2014

**PËR SHPALLJEN E THIRRJES PËR NDARJEN E
FONDIT PËR ART-KULTURË, PYLLËZIM DHE
GJELBËRIM, SI DHE UJËSJELLËS-
KANALIZIME, PJESË E FONDIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 185, datë 28.12.2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpalljen e thirrjes për shpërndarjen e fondeve, nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2014, për projekte në fushat si më poshtë vijon, përkatësisht:

a) Arti dhe kultura, për projekte kulturore, vlerat muzeale e rinore, në vlerën 45 819 000 (dyzet e pesë milionë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë mijë) lekë;

b) Pyllëzimi, gjelbërimi dhe rehabilitimi i zonave mjedisore të dëmtuara, në vlerën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) lekë;

c) Ujësjellës-kanalizime, kryesisht në zonën bregdetare, në vlerën 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë.

2. Aplikimi për fonde të thirrjes për financimin e projekteve në fushat e art-kulturës, pyllëzimit dhe ujësjellës-kanalizimeve, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur. Institucionet aplikuese janë njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimit, shoqëritë sh.a. “ujësjellës-kanalizime”. Aplikimet për projektet dërgohen sipas formatit të dhënë në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Shqyrtimi për financim bëhet për projektet e

aplikuara, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Procedura e vlerësimit kryhet pranë sekretariateve përkatëse teknike në Ministrinë e Kulturës, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas kritereve të dhëna në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Kulturës, ministri i Mjedisit, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Financave dhe Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	anëtar
Ministri i Financave	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	anëtar
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar
Ministri i Shëndetësisë	anëtar
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar
Ministri i Kulturës	anëtar
Ministri i Mjedisit	anëtar
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar

**Shtojcë I: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE
VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE**

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Java 2, qershor 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekt-aplikime për finacimin e projekteve në fushën e artit-kulturës, pyllëzimit, dhe ujësjellës-kanalizimeve.
Java 2 -java 3, qershor 2014	Aplikuesit sipas pikës 2 të këtij vendimi, si më sipër.	Dërgimi e aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon: 1. Aplikimi online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al . 2. Aplikimi me shkresë zyrtare (postë ose dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit dërgohet pranë sekretariateve teknike përkatëse (Ministria e Kulturës për projektet art-kultura, Ministria e Mjedisit për projektet e pyllëzimit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për projektet e ujësjellës-kanalizimeve) 3. Shkresë zyrtare drejtuar Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, me njoftimin dhe listën e projekteve të aplikuara, të renditura sipas prioritetit.
Java 4, qershor 2014	Sekretariatet teknike (Ministria e Kulturës për projektet art-kultura, Ministria e Mjedisit për projektet e pyllëzimit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për projektet e ujësjellës-kanalizimeve)	Vlerësimi teknik e financiar i projekteve të aplikuara, sipas pikës A, shtojca III.
Java 4, qershor 2014	Sekretariatet teknike (Ministria e Kulturës për projektet art-kultura, Ministria e Mjedisit për projektet e pyllëzimit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për projektet e ujësjellës-kanalizimeve)	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve me vlerësimin përkatës teknik dhe financiar.
Java I, korrik 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Vlerësimi i përputhshmërisë me planet vendore, ndërvendore dhe rajonale, i projekteve të aplikuara, sipas pikës B, shtojca III.
Java I, korrik 2014	Sekretariati i Përgjithshëm i KZHR (Njësia e Bashkërendimit të Programeve dhe Planifikimit Strategjik)	Përgatit materialet për vendimmarrje për Komitetin e Zhvillimit të Rajoneve
Java I, korrik 2014	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve (KZHR)	Vendimmarrje në lidhje me projektet për t'u financuar, nga thirrja e financimit për projekte të artit-kulturës, pyllëzimit-gjelbërimit, dhe ujësjellës-kanalizimeve, si pjesë e FZHR.

SHËNIM – Procesi i Vlerësimit

1. Vlerësimi i projekteve të aplikuara kryhet në dy faza. Faza e parë përbën vlerësimin teknik dhe financiar të projekteve, sipas kalendarit të dhënë në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi. Vlerësimi teknik dhe financiar i projekteve, sipas kriterëve teknike të përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur vendimit, kryhet nga sekretariatet teknike për projektet e artit-kulturës, pyllëzimit dhe ujësjellës-kanalizimeve, të ngritur pranë Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mjedisit, dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.
2. Sekretariatet teknike respektive i paraqesin zyrtarisht Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij vendimi, listën e plotë të projekteve me vlerësimin përkatës, të bërë sipas kriterëve të përcaktuara në pikën A, të shtojcës III, bashkëlidhur vendimit.
3. Faza e dytë e vlerësimit të projekteve bëhet sipas afateve të përcaktuara në shtojcën I, të këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve kryen vlerësimin përfundimtar të projekteve, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën B, të shtojcës II, bashkëlidhur vendimit.

Shtojcë II: FORMATI I APLIKIMIT

Aplikuesi (*)	Të vendoset emri i institucionit aplikues: autoriteti i qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë, komunat), agjencitë e zhvillimit dhe shoqëritë Sh.A "Ujësjiellës-Kanalizime.
Data e aplikimit (*)	
Titulli i projektit (*)	
Lloji/sektori i projektit (*)	Të përcaktohet cili është sektori ku bën pjesë projekti (Art-Kulturë, Pyllëzim,Ujësjiellës-Kanalizimet)
Nënsektori i projektit (*)	Të përcaktohet nënsektori i projektit
Data e fillimit të projektit (*)	
Data e mbarimit të projektit (*)	
Përshkrimi i projektit (*)	Të bëhet përshkrim i detajuar i projektit të propozuar, duke përmblajtur informacionin e mëposhtëm, por jo vetëm: - Vendodhja e objektit, territorit ku do të ndërmerret investimi; - Përshkrimi i kushteve si dhe nevojës për këtë projekt; - Përshkrimi i punimeve/ndërrhyrjeve në struktura ekzistuese apo të reja, objekte kulturore; - Kush janë problemet që ky projekt adreson dhe shkalla e ndikimit; - Risqet për zbatimin e tij, etj. Informacioni i dhënë është sipas kriterëve mbi bazën e të cilave do të vlerësohet projekti.
Qëllimi dhe objektivat (*)	Të paraqitet qëllimi i përgjithshëm i projektit si dhe objektivat specifike të tij.
Numri i përfituesve (*)	Të jepet numri i popullsisë që përfiton drejtpërdrejt dhe tërthorazi nga zbatimi i projektit në total. Vlera e dhënë të shoqërohet me shpjegim për secilën kategori përfituesi.
Rendi prioritar (*)	Në rastet e aplikimit të më shumë se 1 projekti, renditni projektet sipas prioritetit/nevojës për ndërrhyrje (numri 1 për shumë prioritar, numri 2 për më pak prioritar, e kështu me radhë).
Qëndrueshmëria e projektit (*)	Të përshkruhet në mënyrë analitike, nëse aplikuesi do të ketë nga ky projekt: - Kosto për mirëmbajtjen e projektit, pas zbatimit të tij; - Nëse po, specifikoni sa parashikohen, si do të sigurohen financimet, etj.
Fondet e kërkuara nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (*)	Në rast se projekti nuk ka bashkëfinancim nga NJQV-të apo nga donatorë, kostoja që kërkohet është e njëjtë me koston totale të projektit.
Kontributi në rast bashkëfinancimi nga njësia e qeverisjes vendore	
Financim nga donatorë	Nëse ka financim nga donatorë
Financime të tjera	Nëse ka burime të tjera financimi
Kostoja totale e projektit (*)	
Projekti ka një analizë kosto-	Po/Jo

përfitim të cilësisë së mirë (Opsionale)	
Përmbledhje e analizës kosto-përfitim	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e analizës kosto-përfitim, nëse ka një të tillë
Projekti ka një vlerësim të ndikimit në mjedis të cilësisë së mirë (Opsionale)	Po/Jo
Përmbledhje e vlerësimit të ndikimit në mjedis	Të paraqitet një përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të ndikimit në mjedis, nëse ka një të tillë
Përshkrim për gatishmërinë e projektit për zbatim (*)	Të përshkruhet nëse projekti është gati për zbatim (pra nëse i disponon të gjitha dokumentet që nevojiten për zbatimin e tij) dhe koha kur mund të fillojë dhe përfundojë procedura e prokurimit publik dhe kur mund të fillojë dhe përfundojë zbatimi i punimeve
Dokumentat e miratimit të projektit nga Njësia e Qeverisjes Vendore (*)	Të paraqiten dokumenta për të vërtetuar nëse projekti: - Ka Vendim të Kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore për miratimin e projektit; - Ka Vendim nga autoritetet kombëtare të kulturës, për miratimin e projektit; - Ka Vendim të Këshillit të njësisë vendore (komunës/qarkut/bashkisë), për miratimin e zbatimit të projektit; - Është përfshirë në listën e miratuar nga Këshilli i njësisë vendore për financim (kur është parashikuar bashkëfinancimi); - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara, nga Ministria e Kulturës (art-kultura). - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara, nga Ministria e Mjedisit (pyllëzimi). - Është në listën e projekteve/nevojave të parashikuara, nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (ujësjellës-kanalizimet). Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet numri dhe data e miratimit të vendimit, si dhe të bashkangjitet një kopje e vendimit/dokumentave të tjerë.
Planifikimi vendor, ndërvendor, rajonal (*)	Të paraqitet dhe të specifikohet nëse projekti është: - pjesë e strategjisë vendore (të bashkisë apo komunës) - pjesë e strategjisë kombëtare për objektet e kulturës, trashëgimisë kulturore (të Ministrisë së Kulturës, institucioneve kombëtare të kulturës, etj); - pjesë e një masterplani kombëtar; - pjesë e strategjisë së zhvillimit të qarkut - pjesë e planeve të investimeve kapitale të njësisë së qeverisjes vendore - pjesë e një plani zhvillimor strategjik (të specifikohet se ç'loj plani) Për të gjitha rastet e sipërpërmendura të cilësohet viti i miratimit të dokumentit strategjik apo planit, si dhe të citohet dokumenti
Dokumentet teknike (*)	Të sqarohet nëse projekti përmban:

	- projektin teknik - preventivin - argumentimin teknik - përlllogaritje/parashikim të kostove të mirëmbajtjes së investimit
--	--

(*) Fushat që kanë * janë të detyrueshme për t'u plotësuar.

SHËNIM: Dërgimi i Aplikimeve, sipas afatit:

1. Aplikimet për projekte duhet të dërgohen:
 - Online në faqen elektronike: www.dsdc.gov.al, si edhe
 - Me shkresë zyrtare (postë), së bashku me dosjen e plotë të aplikimit pranë sekretariateve teknike për projektet e artit-kulturës, pyllëzimit dhe ujësjellës-kanalizimeve, të ngritur pranë Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Mjedisit, dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.
2. Përvec aplikimit si më lart, institucionet aplikuese duhet t'i dërgojnë një shkresë zyrtare Sekretariatit të Përgjithshëm për Zhvillimin e Rajoneve, pranë Këshillit të Ministrave. Shkresa zyrtare përmban njoftimin për dërgimin e aplikimit pranë sekretariateve teknike (MK, MM, MTI) dhe listën e projekteve të aplikuara. Projektet e aplikuara duhet të jenë të renditura sipas prioritetit që i ka dhënë institucioni aplikues.

Shtojcë III: KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Pika A. Projektet e Pyllëzimit dhe Gjellbërimit

A.1. Kriteret e Vlerësimit Teknik dhe Financiar

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi maksimalisht me 70 pikë** i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë së Mjedisit.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimit. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse, projekti që do të financohet, ka:

- Projekt teknik, të saktë dhe qartë, (harta, gentplane, etj.), dhe
- Preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, etj.,

Sekretariati teknik ngarkohet të kryej rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të pregatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 30 pikë.

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elementë të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike.

Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.

3. Niveli i ndikimit të projektit, sipas komponentëve të mëposhtëm:

- Nëse projekti i investimit përfaqëson interesat e më shumë se një njësie vendore. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**
- Nëse projektet ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit në zonat ku zbatohet projekti, rehabilitimin e zonave mjedisore të dëmtuara. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të popullsisë, komuniteteve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë, nga zbatimi i këtij projekti. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.**
6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

A.2. Kriteret e Vlerësimit të Përputhshmërisë

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me **maksimalisht 30 pikë**, sipas kriterëve në vijim:

1. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonar/kombëtar. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**
2. Shkalla e ndikimit në zhvillimin social e mjedisor në qendrat kryesore të rajonit, qarkut, që paraqet projekti. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**

Pika B. Projektet e Ujësjiellës - Kanalizimeve

B.1. Kriteret e Vlerësimit Teknik dhe Financiar

Këto kritere përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi maksimalisht me 70 pikë** i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore, agjencitë e zhvillimit, shoqëritë Sh.A “Ujësjiellës-Kanalizime”. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse, projekti që do të financohet, ka:

- Projekt teknik, të saktë dhe qartë, (harta, gjenplane, etj.), dhe
- Preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, etj.,

Sekretariati teknik ngarkohet të kryej rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të pregatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse. **Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 25 pikë.**

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elementë të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. **Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.**

3. Niveli i ndikimit të projektit, sipas komponentëve të mëposhtëm:

- Nëse projekti i investimit përfaqëson interesat e më shumë se një njësie vendore. Ky kriter inkurajon ato projekte që ngrenë, rehabilitojnë dhe konsolidojnë sistemet e ujësjiellës-kanalizimeve të zonave apo qarqeve të ndryshme. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**
- Nëse projektet janë të orientuara për sistemimin, rehabilitimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujësjiellës-kanalizimeve në zonat bregdetare dhe me interes e potencial turistik. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të popullsisë, komuniteteve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë, nga zbatimi i këtij projekti. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.**
6. Analizat apo studimet që janë kryer në lidhje me projektin, si studimi i ndikimit në mjedis, analiza kosto - përfitim, studimi i fizibilitetit të projektit etj. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**
7. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

B.2. Kriteret e Vlerësimit të Përputhshmërisë

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me **maksimalisht 30 pikë**, sipas kriterëve në vijim:

8. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonar/kombëtar. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**
9. Shkalla e ndikimit në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve dhe faciliteteve bazë (ujësjellës-kanalizimeve) në qendrat kryesore të rajonit, qarkut, që paraqet projekti. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**

Pika C. Projektet e Artit-Kulturës

C.1. Kriteret e Vlerësimit Teknik dhe Financiar

Këto kriteret përdoren nga sekretariatet teknike për të vlerësuar teknikisht projektin dhe në bazë të tyre kryhet **vlerësimi maksimalisht me 70 pikë** i një projekti.

Kriteret 1 dhe 2 detajohen në nënkriteret përkatëse teknike, nga sekretariati teknik i ngritur pranë ministrisë së Kulturës.

Kriteret teknike për vlerësimin e projekteve janë, si më poshtë vijon:

1. Cilësia teknike dhe vlerësimi financiar i projekteve të propozuara nga agjencitë e zhvillimit dhe agjencitë e institucioneve qendrore. Përmes këtij kriteri vlerësohet nëse, projekti që do të financohet, ka:

- Projekt teknik, të saktë dhe qartë, (harta, gentplane, etj.), dhe
- Preventiv dhe kostim të projektit, të përpiluar dhe vlerësuar saktë nga institucioni aplikues, etj.,

Sekretariati teknik ngarkohet të kryej rishikimin financiar të kostimit dhe preventivave të projekteve me potencial, sipas buletineve të çmimeve, kostove referencë etj., si dhe të pregatisë raportin e vlerësimit financiar të tyre dhe rekomandimet përkatëse. **Vlerësimi teknik e financiar do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 30 pikë.**

2. Niveli i ulët i riskut për zbatimin e projektit, bazuar në elementë të përshkrimit të projektit që orientojnë mbi riskun e mundshëm në prokurimin publik, zbatimin me sukses të projektit dhe përdorimin në kohë të fondeve publike. **Vlerësimi i nivelit të ulët të riskut vlerësohet me 0 deri maksimalisht 10 pikë.**

3. Niveli i ndikimit të projektit, sipas komponentëve të mëposhtëm:

- Nëse projekti i investimit përfaqëson interesat e më shumë se një njësie vendore.. **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**
- Nëse projektet promovojnë vlerat kulturore, muzeale e rinore duke kontribuar edhe në zhvillimin e turizmit kulturor, të zonave ku zbatohet projekti . **Për këtë komponent vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri 5 pikë.**

Totali i pikëve të vlerësimit për nivelin e ndikimit shkon nga 0 deri në 10 pikë.

4. Niveli i bashkëfinancimit nga njësitë e qeverisjes vendore apo fondet e donatorëve. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri në maksimalisht 5 pikë.**
5. Numri i përfituesve në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë nga projekti. Vlerësimi sipas këtij kriteri kryhet në varësi të numrit të popullsisë, komuniteteve që përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë, nga zbatimi i këtij projekti. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 10 pikë.**
6. Qëndrueshmëria e investimit nga projekti, që lidhet me faktin nëse janë parashikuar kosto mirëmbajtjeje për projektin në vazhdimësi, të cilat do të merren përsipër nga institucioni aplikues. **Vlerësimi do të bëhet me pikë nga 0 deri maksimalisht 5 pikë.**

C.2. Kriteret e Vlerësimit të Përputhshmërisë

Përdoren nga sekretariati i përgjithshëm për të kryer vlerësimin e projektit nga pikëpamja e të qenit projekt prioritar në nivel vendor, ndërvendor apo rajonal, duke vlerësuar një projekt me **maksimalisht 30 pikë**, sipas kriterëve në vijim:

7. Shkalla e përputhshmërisë me përparësitë/strategjitë vendore dhe/ose të zhvillimit të nivelit rajonal dhe ndikimi në zhvillimin lokal/rajonar/kombëtar. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**
8. Shkalla e ndikimit në zhvillimin kulturor e artistik, në qendrat kryesore të rajonit, qarkut, që paraqet projekti.. **Vlerësimi për këtë kriter përfshin nga 0 deri në maksimalisht 15 pikë.**